



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 32, pika 32.1, shkronja e të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2008, merr

## **V E N D I M**

### **PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHEM TË KATIT TË DYTË TË OBJEKTIT TË QMF-së II – KODRA E TRIMAVE, MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, GJEGJËSISHT QKUK-së**

#### **Neni 1**

Jepet në shfrytëzim të përkohshëm kati i dytë i QMF-së II- Kodra e Trimave, Ministrisë së Shëndetësisë, gjegjësisht QKUK-së për nevojat e Hemodializës.

#### **Neni 2**

Të gjitha shpenzimet për rregullimin e katit të dhënë në shfrytëzim, gjegjësisht shpenzimet komunale, shpenzimet për riparimin dhe adaptimin e objektit dhe të gjitha shpenzimet e tjera të nevojshme do t'i bartë shfrytëzuesi, respektivisht Ministria e Shëndetësisë dhe QKUK-ja.

#### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale do t'i kryejë punët nga përgjegjësitë e veta të caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Afati kohor i dhënies në shfrytëzim me qira, si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të jetë pesë vjet, me mundësi vazhdimi.

#### **Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.Nr. 031-1601, më 29.10.2008**

**KRYETAR I KOMUNËS**  
**Prof.dr. Isa Mustafa**